Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**25.08.2023**	**08.09.2023**	**2023/0568**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.08.2023, OE "Rojet e Nderit SH.P.K"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0568, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: "616-19-3238-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,100,000.00 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 17.05.2019

Hapja e Tenderëve: 13.06.2019

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë janë nxjerr disa vendime të mëparshme të OSHP - së, më Nr. 2023/0568 i dt: 18.08.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

- Ligji Nr. 04/L-042PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 .
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
- Neni 27 Dosja e Tenderit.
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Të nderuar

Bazuar në LPP-në përkatësisht neni 1 Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
Në këtë AP nuk është as duke u zbatuar LPP dhe as nuk janë duke u përdorur fondet publike në mënyrë efikase sig na detyron LPP, këtë e themi pasi që ky AK duke na diskriminuar neve si OE dhe duke përdorur forma jo efikase ato të negociuara në këtë rast duke shkelur edhe neni Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, pasi që AK me vlerë shum më të lartë se vlera shërbimit që merr AK përmes formave të negociuara është më e lartë se vlera e ofertës tonë,duke dëmtuar buxhetin në masë të madhe.

Edhe pse për të disaten herë neve kemi marrë të drejten tonë nga ana e Panelit Shqyrtues AK prap në kundërshtim me Këto vendime dhe LPP ka anuluar prap me të njëjtat pretendime por kësaj radhe duke fsherhur atë që vetë ka potencuar,

Me datë 28.07.2023 kemi bërë kërkes për rishqyrtim për këtë AP ku kemi potencuar dhe per aryse të transparences ne po e ri-shkruajm

"arsyetime" të paqëndrueshme duke mos respektuar LPP-në.

Ne nuk pajtohemi me konstatimin tuaj ku keni cekur që

paraprake te rivlerësimeve ndërsa OE i mbetur ne gare është OE "Rojet e nderit" qe ka tejkaluar vlerën e parashikuar për 1,007,462.40 euro.
I njëjti OE gjate procedurës ka parashtruar pyetje se a mund te tejkalohet vlera e parashikuar për shkak te buxhetit te ulet te parashikuar dhe AK ka kthyer përgjigje se ofertat financiare mund te shfrytëzohen edhe +30% qe dmth ofertat kane mund te dorëzohen deri ne vlerën 2,730.000 euro ndërsa oferta e OE Rojet e Nderit është tejkaluar nga vlera e parashikuar dhe plus 30% i saj për 377,462.40 euro, dmth OE nuk ja ka përmbajtur sqarimeve gjate procedurës se oferta mund te zgjatet dhe te shfrytëzohet deri ne vlerën 2,730.000 euro.

Edhe pse është shumë e qartë se ky konstatim I juaji nuk qëndron neve prap po u'a sqarojm duke I'u lutur që most ë largoni/fshehni asnjë rresht të sqarimeve të ofruara nga ju pasi që e vërteta është kështu:

Pas njoftimit për kontratë për këtë aktivitet me datë: 03.06.2019 keni ofruar sqarime lidhur me tejkalimin e buxhetit ku pyetja ka qenë "CITOJ"

5.Sipas kërkesave në DT-Aneksi PERSHKRIMI I CMIMEVE :kërkesa për sigurimin e të gjitha objektëve (Pozitave) arrin fondin oreve 1'423'008 ne total për periudhen 36 mujore dhe kërkesa e juaj në DT është qe Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofruesi i sherbimeve kërkohet të jetë së paku 250 € për një muaj dhe Ofruesi i Shërbimeve gjatë realizimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës.

Departamenti i kontabilitetit ne kompaninë tonë, ka analizu dhe ka bere llogaritjen sipas kërkesës për pagen 250.00 euro (muaj) për një punëtor,atehere është vereitur dhe vërtetuar se Vlera e parashikuar për këtë kontratë sipas FDT prej 2'100'000.00 euro nuk e mbulon koston reale për pagat e punëtorve dhe shpenzimeve tjera operative sipas kërkeses se DT - Megense sipas llogaritjeve tona vlera e ofertave të OE do të tejkaloj dukshëm buxhetin e parashikuar të Autoritetit të juaj,gati dikund 3'000'000.00€

Pyetja jonë është: Se si do të veprohet me tutje apo do të anulohet i terë procesi i tenderimit?

PËRGJIGJËJA JUAJ

5.Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes se tenderit, saktesisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike qe do te thote se Kontarta Kornize mund te shtohet dhe per 30%e qe arrine vleren 2.730.000,00.

Kur te arrihet kjo vlere sipas dispozitave ligjore Kontrata Kornize duhet te ndërpritet.

Provë: SQARIMI JUAJ DATË 03.06.2019 (i dorëzuar në sistem të Eprokurimit).

Pra "ARSYETIMI" se të gjithë OE-të kanë tejkaluar buxhetin nuk qëndronë pasi që sqarimet tuaja para hapjes së ofertave kanë lënë një mundësi të tillë dhe kemi vepruar konfrom sqarimeve tuaja.

Për koiqidnec apo qellimisht nuk e kuptojm por në vendimin tuaj të datës vendimi i datës 19.05.2021 ju keni cekur CITOJ:

> -Pretendimi juaj se sqarimet tona e kane kushtezuar çmimin e tenderit tuaj poashtu eshte i pa qendrueshem,pasiqe ju keni cekur vetem nje pjese te teksit:"Lidhur me pyetjen tuaj referojuni dosjes se tenderit,saktesisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike qe do te thot se kontrata kornize mund te shtohet per 30%e qe arrin vleren prej 2.730,000.00 €",ndersa nuk e keni perfshire pjesen tjeter te pergjigjes qe sqaron se kemi te bejme me kontrate kornize dhe e njejta mund te nderprehet ne momentin qe arrin vleren e parashikuar,e cila pjese tregon qarte se nuk ka pase asnje kufizimin per çmimin tuaj as te tenderueseve tjere.Poashtu ne sqarimet tona eshte cekur se tenderuesit duhet ti perfshijne ne çmimet e tyre te gjitha detyrimet ligjore dhe ata qe nuk i pershijne te njejtat do te trajtohen si te pa pergjegjshem.
> -Poashtu ju sqaroj se lidhur me tenderuesin e propozuar ne asnje rast as Autoriteti Kontraktues e as OSHP-ja nuk e kane trajtuar tenderuesin :"Rojet e Nderit"si te pa pergjegjshem,por vetem eshte konstatuar se çmimi i tij eshte mbi vleren e parashikuar;
> -
> Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.

Pra keni thënë se OE ka fshehur nuk e ka përfëshir pjesën tjetër ku thuhet se Kur te arrihet kjo vlere sipas dispozitave ligjore Kontrata Kornize duhet te ndërpritet.

Pretendimi juaj se

Komisioni i vlerësimin e sheh te udhës te behet anulimi i aktivitetit edhe për faktin se dosja e tenderit respektivisht përshkrimi ne paramase nuk është bere si duhet, AK nuk e ka cekur qarte numrin e punëtoreve që OE është i obliguar te angazhoj, kjo ka krijuar një situate qe secili OE ka bere përcaktimin e numrit te punëtoreve sipas planit te tyre.
Kjo e bene te pamundur analizimin real te çmimit te secilit OE, qe te dihet vërtet se OE-të i kane kalkuluar si duhet pagat duke u bazuar ne ligjin për paga siç është cekur në dosje të tenderit.
AK në dosje -paramasa ka përshkruar vetëm numrin e pozitave dhe orëve pa specifikuar numrin minimal te punëtorëve për këtë aktivitet shërbimi.

Për këtë konstatim të komisionit po u'a sqarojm se lehtësisht duke marrë një form tuajen se si llogaritet nr I punëtorëve form e cila është shumë ligjore dhe e lehtë për ta kuptuar.

Kurse për të nxjerrur numër të punëtorëve duhet kalkuluar si vijonë sipas udhëzimit të MPMS Nr/09/2017 ku fondi I orëve për një punëtor është 176 orë. dmth numëri total I orëve për secilen pikë /176 jep numër të punëtorëve.
(Marrë nga ANEKS 1 i aktivitetit tuaj me nr prokurimi 616-23-5765-2-1-1).

Nuk pajtohemi dhe nuk qëndron asnjë nga konstatimet e komisionit pasi që para hapjes asnjë nga OE-të pjesëmarrëse nuk ka shprehur shqetësi m për paqartësit e DT-së.

Ju jeni duke vazhduar me formen e negociuar për marrjen e shërbimeve me vlerë dukëshem më të shtrnjet që bien ë kundështim me nenin Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti ku ceket 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

Të nderuar neve pa dashur të stërgjasim kërkesen tonë kërkoim nga ju që të aprovoni duke na ri-shpallur si OE me çmimin më të lirë të përgjegjëshëm konfrom vendimeve tuaj të OSHP-së dhe LPP-së duke mos na diskriminuar në këtë form.

Në vendimin e kërkese për ri-shqyrtim AK potencon sipas nenit 108/A paragrafi 10 pika 10.2 e cila sipas ligjit kerkesa duhet aprovuar por më poshtë del që AK ka refuzuar.

AK përveq se ka bërë vlerësim të gabuar,nuk ka përfshir të gjithë atë se qka është sqaruar para hapjes ku është cekur qartë se pra e gjithë poenta është se tek sqarimi

5.Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes se tenderit, saktesisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike qe do te thote se Kontarta Kornize mund te shtohet dhe per 30%e qe arrine vleren 2.730.000,00.

Kur te arrihet kjo vlere sipas dispozitave ligjore Kontrata Kornize duhet te ndërpritet.

Po ashtu vetë AK në një vendim ka potencuar

-Pretendimi juaj se sqarimet tona e kane kushtezuar çmimin e tenderit tuaj poashtu eshte i pa qendrueshem,pasiqe ju keni cekur vetem nje pjese te teksit:"Lidhur me pyetjen tuaj referojuni dosjes se tenderit,saktesisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike qe do te thot se kontrata kornize mund te shtohet per 30%e qe arrin vleren prej 2.730,000.00 €",ndersa nuk e keni perfshire pjesen tjeter te pergjigjes qe sqaron se kemi te bejme me kontrate kornize dhe e njejta mund te nderprehet ne momentin qe arrin vleren e parashikuar,e cila pjese tregon qarte se nuk ka pase asnje kufizimin per çmimin tuaj as te tenderueseve tjere.Poashtu ne sqarimet tona eshte cekur se tenderuesit duhet ti perfshijne ne çmimet e tyre te gjitha detyrimet ligjore dhe ata qe nuk i pershijne te njejtat do te trajtohen si te pa pergjegjshem.
-Poashtu ju sqaroj se lidhur me tenderuesin e propozuar ne asnje rast as Autoriteti Kontraktues e as OSHP-ja nuk e kane trajtuar tenderuesin :"Rojet e Nderit"si te pa pergjegjshem,por vetem eshte konstatuar se çmimi i tij eshte mbi vleren e parashikuar;
-
Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.

Të nderuar ua bëjmë me dije se vendime,përgjigjiet nuk janë as kanë të bëjnë me mendime personale por janë veprime institucionale të cilat duhet zbatuar dhe jo të bëhet këso lloj diskriminimi I pa bazë. Ne po u'a bëjmë të qartë për deri sa kemi bërë kërkes për sqarim dhe kemi paranjoftuar se mund të tejkalohet buxheti dhe kemi pyetur se a do të anulohet tenderi dhe vetë AK potencon qartë se jo dhe madje egzistojn disa vendime të vetë AK-së ku jemi shpallur fitues për kontratë dhe përderisa AK merr shërbime në forma tjera më të disfaroëshme se ajo që është e përcaktuar me ligjë.

AK në vendimin e datës 03.08.2023 hudhë poshtë pretendimet tona duke u marrë vetëm sipërfaqësisht por jo edhe me vetë deklaratat e AK-së të cilat I kemi shfaqur që janë bazë kryesore e pretendimit se neve kemi të drejtë.

AK në vendim potencon se neve nuk kemi atakuar arsyetim e AK sipas nenit 62 se kinse vendimi I AK është në përputhje me këtë nenë ne dekalrojm se kemi cituar se AK ka bërë shkelje të komplet

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

AK nuk ka pasur e as nuk ka mundur që sipas vendimit të OSHP-së nr 42/23 I datës 25.05.2023 pasi që është cekur qartë se:

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, sqaron se deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi është arritur duke konsideruar veprimet e AK të ndërmarra në rastin konkret, anulimi mbi bazën e tejkalimit të vlerës së parashikuar duke aplikuar nenin 62, PSH ka arritur në konstatimin se arsyetimi i tillë nuk ka qenë argumentues dhe i mbështetur në fakte të mjaftueshme të cilat dëshmojnë se aplikimi i nenit 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit) është arritur duke aplikuar paragrafin 2, pikën 1, i cili përcakton se AK-të mund ta përfundojnë i aktivitetin e prokurimit nëse: *të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit,* gjithashtu PSH ka konsideruar bazën argumentuese të OE ankues i cili në ankesën e tij ka paraqitur poashtu sqarimin e kërkuar nga AK para dorëzimit të ofertave, të datës 03.06.2019 me të cilin janë drejtuar AK-së se pas analizës së kërkesave të DT, në bazë të cilave arrihet fondi i përgjithshëm i 1.423.008 orëve pune për periudhën 36 mujore dhe përderisa kërkesa është që paga mujore bruto të jetë së paku 250 euro në muaj, AK është përgjigjur si në vijim: *Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes së tenderit, saktësisht Aneksi 1 tek specifikimet teknike që do të thotë se Kontrata Kornizë mund të shtohet edhe për 30 % e që arrine vleren 2.730.000,00."* , poashtu PSH ka konsideruar faktin që lidhur me aktivitetin e njëjtë të prokurimit AK përgjatë procedurave të mëhershme veçse ka rekomanduar OE të tjerë e poashtu OE ankues, andaj baza arsyetuese lidhur me aplikimin e nenit 62 konsiderohet si e mangët dhe jo bindëse duke konsideruar të gjitha rrethanat dhe veprimet e

Veprimet e AK-së na bënë të zbehim besimin tonë që nga institucionet përgjegjëse të vlerësohet drejtë, edhe pse për shumë herë me radhë na është dhënë e drejta nga ana OSHP-së se neve kemi të drejtë por se AK qdohere në kundërthënje me sqarimet kërkesat E DT-së si dhe vendimet e marra disa herë për të na shpërblyer me kontratr si dhe vendimet e OSHP-së.

Për mos ta stërgjatur neve po bashkangjesim edhe ankesen e datës 16.01.2023 ku është përshkruar komplet ecuria e këti AP.

PANEL I nderuar bazuar në kornologjinë e deri tanishme në këtë AP kërkojm që të aprovoni ANKESEN tonë dhe që të veproni konform LPP-së, dhe të detyroni/URDHËRONI AK-në që të veproj konform LPP-së dhe vendimeve të AK-së dhe tuaja që qdohere janë të mirë bazuar.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).	**1. Një listë te kontratave të realizuara, d plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku du saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontra datën e fillimit dhe datën e përfundimit përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referen ose certifikatat për kryerje te punëve. a) I shërbimi është bërë për një autoritet publik Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhe dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca lëshuara nga autoriteti i tillë. b) Kur shërb është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzo certifikata e pranimit ose referenca të lëshuara blerësi i tillë.**
Kërkesa 2. OE DUHET TE DEKLAROHET SE PUNETOREVE DO TUA PAGUAJ PAGEN MINIMALE BRUTO 250€	**2. DEKLARATA E NENSHKUAR DHE VULOSUR NGA OE**
Kërkesa3. OE duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) një (1) Menaxher te projektit i cili duhet te ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit zyrtar në detyrë dhe të posedojë licencën valide të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme b) dy (2) ndihmesa për projekt menaxherin te cilët duhet te ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit zyrtar në detyrë dhe të posedojë licencën valide të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme	**3. a) Për Menaxherin e Projektit Kopj diplomës universitare, CV, referenca pune kopja e licencës për trajnimin e specializuar, b) ndihmesat Kopja e diplomës se shkollës se mes CV, referenca pune, dhe kopja e licencës trajnimin e specializuar**
Kërkesa 4. OE duhet te kete te gjitha pajisjet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve te sigurimit themelor, si Breza, Shufra, Pranga, Bateri ndricuese, Radio	**4. DEKLARATA E NENSHKUAR DHE VULOSUR NGA OE**

Lidhje mobile dhe fikse etj	
Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet te posedoj ose te marr me qira se paku 8 (tete) Automjete patrulluese	**5. Kopjet e librezave te regjistrimit te Automje (me validitet regjistrim. Ne rastet kur OE mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dor edhe marreveshjen per shfrytezim.**
Kërkesa 6. OE duhet te posedoj minimum 8 (tete) Operator te Sigurisë të licencuar për monitorimin e sistemeve te sigurisë (Operator nënkupton stafi i angazhar nga operatori ekonomik, i cili staf është i licencuar për monitorimin dhe vëzhgimin e sistemeve të sigurisë), dhe 2 Menaxher për OME.	**6. Lista e stafit dhe licencat valide per operat dhe menaxheret për OME**
Kërkesa 7. OE duhet te ketë Marrëveshje me një Qendër Trajnimi te licencuar për kryerjen e trajnimeve te rojeve te sigurimit ne fushën themelore dhe te specializuar sipas Ligjit Nr.04 L-004, për Shërbimet Private te Sigurisë.	**7. Kopja e marrëveshjes dhe kapja e licenses qendrës se trajnimit për shërbimet themelore dh specializuara (valide)**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rojet e Nderit" Sh.P.K. të datës 27.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-19-3238-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 19 030 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rojet e Nderit" Sh.P.K. e datës 27.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-19-3238-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 19 030 211.

II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e datës 25.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Rojet e Nderit" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rojet e Nderit" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-19-3238-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 19 030 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "*Ne nuk pajtohemi me konstatimin tuaj ku keni cekur që OE I mbetur në garë është OE Rojet e Nderit Sh.P.K.*

që ka tejkaluar vlerën e parashikuar për 1,007,462.40 euro. I njëjti OE gjatë porcedurës ka parashtuar pyetje se a mund të tejaklohet vlera e parashikuar dhe AK ka kthyer përgjigjëje se oferatat financiare mund të shfrytëzohen deri në /-30% që dmth ofertat kanë mundur të dorëzohen deri në vlerën 2,730.000 euro ndërsa OE Rojet e Nderit është tejkaluar nga vlera e parashikuar dhe plus 30% I saj për 377,462.40 euro, dmth OE nuk ja ka përmbajur sqarimeve se oferta mund të zgjatet dhe të shfrytzohet deri ne vleren2,730.000 euro".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7, 27, 59 dhe 60 të LPP si dhe nenin 37 të RRPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 03.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit: fillimisht duhet cekur se me datë 25.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar B58 - Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit ka njoftuar se është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si në vijim: "*Të gjithë operatorët ekonomik kanë tejkaluar vlerën e parashikuar në mënyrë substanciale apo janë eliminuar për arsye të ndryshme nga vendimet e autoritetit kontraktues ose nga vendimet e OSHP gjatë proceseve paraprake të rivlerësimeve... Autoriteti Kontraktues në dosje - paramasë ka përshkruar vetëm numrin e pozitave dhe orëve pa specifikuar numrin minimal të punëtorëve për këtë aktivitet të shërbimit. Meqenëse shkeljet në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të korigjohen në këtë fazë, konsiderojmë që është më mirë të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit ashtu që me rastin e ritenderit Autoriteti Kontraktues të hartoj kritere më të matshme, të specifikuara mirë dhe respektuar LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi*".

Pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit është se i njëjti nuk ka tejkaluar buxhetin e planifikuar për aktivitetin e prokurimit mirëpo me rastin e ofertimit ka përfshirë në çmim edhe +30% të vlerës së parashikuar duke marrë për bazë sqarimet shtesë të Autoritetit Kontraktues të Datës 03.06.2019. Në këtë drejtim duhet cekur se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është 2,100,000.00 Euro. Ndërsa oferta që ka dorëzuar parashtruesi është 3,107,462.40 Euro përkatësisht 1,007,462.40 Euro më e lartë sesa vlera e parashikuar për aktivitetin e prokurimit. Vlen të theksohet se me datë 03.06.2019 Autoriteti Kontraktues ka ofruar sqarime shtesë ashtu që në pyetjen e parashtruesit nëse vlera e parashikuar është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e aktivitetit, Autoriteti Kontraktues është përgjigjur si në vijim "*Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes së tenderit, saktësisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike që do të thotë se Kontrata Kornizë mund të shtohet dhe për 30% e që arrinë vlerën 2.730.000,00 Euro*". Këtë përgjigje Autoriteti Kontraktues e ka mbështetur në nenin 54 paragrafin 54.11 ku përcaktohet se te kontratat kornizë "*Mospërputhja e lejuar konsiston në plus/minus tridhjetë përqind (30%) të pragut apo tavanit të sasive totale apo vlerës totale indikative të kontratës*". Duhet cekur se ky tejkalim i referohet situata kur Autoriteti Kontraktues deklaron mospërputhjen në dosje të tenderit apo me urdhër blerje, por nuk nënkupton edhe tejkalimin përmes ofertave tenderuese.
Nëse vlera e parashikuar për kontratë është 2,100,000.00 Euro dhe nëse kësaj vlere i shtojmë 30% të saj, atëherë arrijmë deri te vlera 2,730,000.00 Euro. Megjithatë parashtruesi ka ofertuar me 3,107,462.40 Euro. Rrjedhimisht oferta e parashtruesit ka

tejlakuar edhe vlerën përtej tejkalimit të lejuar prej 30% të vlerës së parashikuar për 377,462.4 Euro. Pra jo vetëm që është tejkaluar vlera e parashikuar por edhe me rastin e ofertimit është tejkaluar edhe 30% i lejuar për tejkalim (sipas kritereve të përcaktuara me RRPP). Me fjalë të tjera është konfirmuar si i saktë konstatimi i komisionit vlerësues se është tejkaluar substancialisht vlera e parashikuar për aktivitetin e prokurimit.

Pavarësisht që nuk është kontestuese ligjshmëria e vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, vlen të thuhet që ky vendim i Autoritetit Kontraktues është në përputhje të plotë me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 2 të LPP ku përcaktohet se Autoriteti Kontraktues mund të përfundoj një aktivitet të prokurimit nëse "*të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit*". Megjithatë ky fakt as që është kontestuar nga parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi nr. 735,744,757/19; Vendimi nr. 82,83,92/20; Vendimi nr. 332/20; Urdhëresë nr. 563/20; Vendimi nr. 896,912/20; Vendimi nr. 230,267/22; Vendimi 359/22; Vendimi 42/23;

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Rojet E Nderit SH.P.K.**

Sqarim hyrës:

Me datën: 28.07.2023, OE "Rojet e Nderit SH.P.K"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0568, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: "616-19-3238-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. Më poshtë eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit është filluar qysh më datë 19.06.2019 dhe për të njëjtin ka një numër të madh të ankesave të cilat janë parashtruar në OSHP dhe si përgjigje ndaj tyre janë nxjerrë gjithsej 7 vendime nga panelet shqyrtuese-OSHP dhe vendime nga AK.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në rrjedhën kronologjike dhe kohore të këtij aktiviteti të prokurimit dhe duke i analizuar çmimet ofertuese të të gjithë Operatorëve Ekonomik të cilët kanë ofertuar, sqaron se vlera e ofruar nga secili operator ekonomik që ka marr pjesë në këtë aktivitet prokurimi kalon vlerën e parashikuar për të njëjtin.

AK me datën 06.01.2023 kishte marr vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit nën arsyetimin se: *AK- Komisioni për rivlerësimin e ofertave gjatë ekzaminimit të ofertave konstatoi se të gjithë OE që kanë ofertuar kanë tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë projekt. Vlera e parashikuar e këtij projekti ka qenë 2,100,000.00 euro.*

Sipas Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 2, pika 2.1 thotë si në vazhdim- 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për

aktivitetin e prokurimit;

Duke u bazuar në nenin 62 të LPP-së si dhe çmimet e ofertimit të OE për këtë aktivitet prokurimi, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pasi që të gjithë OE kanë tejkalur vlerën e parashikuar nga AK për këtë Aktivitet Prokurimi, atëherë AK- Komuna e Prishtinës ka të drejtë në marrjen e vendimit për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Prokurim Publik.

Provë: Lista e OE të cilët kanë ofertuar dhe çmimi total i ofertës së tyre

Numri i aktivitetit te prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616 19 030 211

Radhë	Lënda / grupi: **Sigurimi I objekteve te Komunes se Prishtines**	Çmimi total i ofertës (me TVSH)	Vlera e parashikuar e ofertes	Tejkalimi I vleres se parashikuar per:
1.	Rojet e nderit Shpk, Prishtine 10000 Prishtine	**3.107.462,40**	**2.100.000,00**	**1.007.462,40**
2.	Grupi I Operatoreve Ekonomik Internat Security Association Shpk; Nazeri 2000 Shpk Dega ne Kosove. Mustafe Kruja nr 3.10000 Prishtine	**2.379.456,00**	**2.100.000,00**	**279.456,00**
3.	Grupi I Operatoreve Ekonomik Commando Shpk; Group for security Shpk; Aulona-Pol-1 Shpk, Rr. 11 marsi Lam.2/2 20000 Prizren	**2.729. 376,00**	**2.100.000,00**	**629.376,00**
4.	Security Code Shpk, Muharrem Fejza – BLL, III.Hy.IVLokali.15-1, 10000 Prishtine	**2.676.585,00**	**2.100.000,00**	**576.585,00**
5.	K.S. Besa Security Shpk, Rruga Jusuf Gervalla . nr. 64. 10000 PRishtine	**2.561.414, 40**	**2.100.000,00**	**461.414,40**

Pra siç mund të shihet edhe nga tabela e mësipërme, të gjithë OE përfshirë këtu edhe OE ankues- Rojet e Nderit kanë ofertuar me çmime shumë më të larta se sa vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit. Përderisa vlera e parashikuar është **2,100,000.00 €,** vlera e ofertuar e OE ankues- Rojet e Nderit është **3,107,462.40 €,** përkatësisht vlera e ofertuar është për 47.97% më e lartë se ajo e parashikuar apo 1,007,462.40 € më shumë.

LPP sqaron qartë mënyrën se si funksionon një kontratë kornizë, mirëpo edhe nëse do ishte marr parasysh përgjigja që AK kishte dhënë me datë 03.06.2019 e cila edhe në këtë rast nuk është në përputhje me LPP-në, lidhur me pyetjen e parashtruar nga OE ankues nëse vlera e parashikuar është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e aktivitetit, ku AK kishte thënë se "Kontrata Kornizë mund të shtohet edhe për 30% e që arrinë vlerën 2,730,000.00€", përsëri vlera e ofertuesit është shumë më e lartë në krahasim me vlerën e parashikuar. Andaj duke u

bazuar në këtë çfarë u sqarua më lartë, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili shpjegon se kur një aktivitet i prokurimit mund të anulohet.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Rojet E Nderit SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi